

Ndonëse për vite më radhë zinte vendin e parë në renditjen e universiteteve më të mira në botë, Universiteti i Harvardit tani gjendet në vendin e katërt.

Vendin e parë aktualisht e mban Instituti për Teknologji i Massachusetts.

Radhitjen e Universiteteve e bënë një institut me renome botëror, duke u bazuar në disa kritere si: reputacioni akademik 40%, reputacioni i punëtorëve 10%, përkushtimi i studenteve në studime 20%, citimet e punimeve të fakulteteve 20%, numri i studenteve ndërkombëtar 5%, si dhe stafi ndërkombëtar 5%.

Shumica e universiteteve më të mira janë anglosaksone, kryesisht të përqendruara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Mbretërinë e Bashkuar, transmeton lajmi.net.

Universitetet e Kosovës nuk bëjnë pjesë fare në këtë ranglistë, dhe siç duket nuk i janë nënshtruar evaluimit, ndërsaq Universiteti i Beogradit, ku kanë studiuar shumë profesorë të sotëm që punojnë në Kosovë radhitet i 701. Ndërsaq ai i Zagrebit mbi 600.

Më poshtë janë të radhitura top 20 universitetet më të mira në botë.

1. Massachusetts Institute of Technology (USA)
2. University of Cambridge (Angli)
3. Imperial College London (Angli)
4. Harvard University (USA)
5. University of Oxford (Angli)
6. UCL (University College London) (Angli)
7. Stanford University (USA)
8. California Institute of Technology (USA)
9. Princeton University (USA)
10. Yale University (USA)
11. University of Chicago (USA)
12. Swiss Federal Institute of Technology (Zvicër)
13. University of Pennsylvania (USA)
14. Columbia University (USA)
15. Johns Hopkins University (USA)
16. Kings College London (Angli)
17. The University of Edinburgh (Angli)
18. Ecole Polytechnique Federale de Lausanne (Zvicër)
19. Cornell University (USA)
20. University of Toronto (Kanada)